



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE PAAFTËSISË

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN
ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR
BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË
TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR.**

Në mbështetje të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligji nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” i ndryshuar, Vendimit nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Nr.5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok-Ndihmën Ekonomike deri në 6%”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak,

PËR TË VENDOSUR

1. Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si më poshtë vijon:
 - Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit dhe plotësojnë kushtet e mëposhtëme:
 - Familja përpara se të perzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond duhet të jetë verifikuar paraprakisht nga administratori shoqëror.
 - Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
 - Familjet me kryefamiljare gra, të veja, të divorcuara, me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.

- Familje me kryefamiljare vajza nënë dhe me fëmijë nën 16 vjeç.
 - Të moshuar të vetmuar.
 - Rastet kur k/familjari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paafte për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk perfitojnë pagesa PAK.
2. Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fonde të pushtetit vendor, si më poshtë vijon:
- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
 - Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
 - Rastet kur k/familjari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paafte për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk perfitojnë pagesa PAK.
 - Familjet me kryefamiljare gra, (të veja, të divorcuara), me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
 - Familjet të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, por që kanë probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin, etj), të cilët kanë vështirësi punësimi.
 - Familjet rome, të cilat kanë problem me rregjistrimin dhe transferimin.
 - Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftueshme.
 - Familjet me kryefamiljare gra, të cilat kanë të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë dhe ju ka përfunduar urdhëri i mbrojtjes.
3. Masa e ndihmës ekonomike për çdo familje do të përllogaritet sipas Udhëzimit Nr.4, date 17.02.2017 “Për përllogaritjen e përfitimit të Ndihmës Ekonomike”.
4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE
Drejtore

Alncida Rroshi

DREJTORIA SHËRBIMIT SOCIAL
Drejtore

Meme Xhaferaj

KRYETAR

Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE PAAFTËSISË

RELACION

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR.

Në mbështetje të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligji nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” i ndryshuar, Vendimit nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, të ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Nr.3,4,5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok-Ndihmën Ekonomike deri në 6%“, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025”, Drejtoria e Shërbimit Social paraqet këtë relacion për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor.

1. Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si më poshtë vijon:
 - Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - Familja përpara se të perzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond duhet të jetë verifikuar paraprakisht nga administratori shoqëror.
 - Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

- Familjet me kryefamiljare gra, të veja, të divorcuara, me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
 - Familje me kryefamiljare vajza nënë dhe me fëmijë nën 16 vjeç.
 - Të moshuar të vetmuar.
 - Rastet kur k/familjari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
2. Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fonde të buxhetit vendor të Bashkisë Durrës si më poshtë vijon:

- Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
 - Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jenë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
 - Rastet kur k/familjari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
 - Familjet me kryefamiljare gra, (të veja, të divorcuara), me të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë.
 - Familjet të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, por që kanë probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin, etj), të cilët kanë vështirësi punësimi.
 - Familjet rome, të cilat kanë problem me regjistrimin dhe transferimin.
 - Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftueshme.
 - Familjet me kryefamiljare gra, të cilat kanë të paktën një fëmijë që ndjekin arsimin bazë ose të lartë dhe ju ka përfunduar urdhëri i mbrojtjes.
- Masa e ndihmës ekonomike për çdo familje do të përllogaritet sipas Udhëzimit Nr.4, date 17.02.2017 "Për përllogaritjen e përfitimit të Ndihmës Ekonomike".

Duke Ju falenderuar,

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

DREJTOR

Meme Xhaferaj

